



N.T.P. "Butterfly"
 Rr. Industria, pn. Shtime
 Ferizaj, Kosovë
 Tel: +383 (0)49 200 006
<https://butterfly-rks.com/>

Për: Kryesuesin dhe Kuvendin Komunal në Shtime, Republika e Kosovës
Nga: Korab Hoxha B.I. (N.T.P. Butterfly)
Lënda: Kërkesë për miratim për vendosjen e hipotekës mbi parcelë dhe objekt
Data/Vendi: Shtime 20.04.2026

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Kompania **Korab Hoxha B.I. (N.T.P. Butterfly)** është themeluar në vitin 2008 dhe ushtron aktivitet në fushën e shitjes me shumicë të produkteve jo-ushqimore. Aktualisht, kompania ka rreth 47 punonjës, prej të cilëve 42 janë banorë të Komunës së Shtimes dhe rrethinës, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik lokal.

Në vitin 2019, kompania jonë ka përfutur të drejtën e shfrytëzimit të parcelave me numër **P-72809093-01398-22** dhe **P-72809093-01398-24**, të vendosura në Parkun Industrial në Shtime. Në vijim të kësaj, kemi realizuar investim në ndërtimin e objektit afarist, për të cilin kemi siguruar lejen ndërtimore dhe kemi bërë funksionalizimin e tij në janar të vitit 2020. Pas përfundimit të të gjitha procedurave ligjore, është siguruar edhe certifikata pronësore për objektin me numër **O-72809093-01398-22-10-0**.

Pavarësisht nivelit të konsiderueshëm të investimit të realizuar, aktualisht kompania nuk ka mundësi ta përdorë këtë aset si garanci (kolateral) pranë institucioneve financiare, për shkak të nevojës për marrjen e pëlqimit nga Kuvendi Komunal, në përputhje me kushtet e shfrytëzimit të pronës komunale.

Në këtë drejtim, duke pasur parasysh rëndësinë e sigurimit të financimit për zhvillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit ekonomik, si dhe ndikimin pozitiv në punësim dhe zhvillim lokal, ju drejtohem me këtë kërkesë që të:

Miratoni lejimin e vendosjes së hipotekës mbi parcelat e lartshënuara dhe objektin e ndërtuar mbi to, me qëllim që i njëjti të mund të përdoret si kolateral pranë institucioneve financiare në Republikën e Kosovës.

Ky veprim nuk cenon të drejtat pronësore të Komunës, por shërben si mekanizëm për sigurimin e financimit, duke mundësuar vazhdimësinë dhe rritjen e aktivitetit ekonomik të kompanisë.

Me respekt
 Korab Hoxha



NC-044-177-087